



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 18254 Prishtinë 02.06. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Granit Hasani** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Hidrocentralet e vogla dhe studimi mbi ndërtimin e HCV Majanci** ” në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakt

Hidrocentralet paraqesin një nga format e energjisë së ripërtërishme për prodhim të energjisë elektrike. Me anë të transformimit, nga energjia potenciale e pozitës (akumulacioni) në energji kinetike të lëvizjes (kanali) pastaj në energji mekanike (turbina) energjia shndërrohet në energji elektrike (gjeneratori).

Rasti studimor ka të bëjë me analizën e mundësisë së prodhimit të energjisë me anë të ndërtimit të një hidrocentrali në fshatin Majac në Komunën e Podujevës, duke shfrytëzuar ujin e lumit Kaçandolli.

Hulumtimi është ndarë në dy pjesë ku pjesa e parë ka të bëjë me hulumtimin në literaturë, kurse pjesa e dytë me analizë të rastit studimor nga aspekti gjeografik, gjeologjik, hidrologjik, elektroenergjetik, ambiental e ekonomik.

Duke pasur parasysh që vendi ynë përballlet me mungesa të kapacitetit energjetik poashtu, varet kryesisht nga burime të shterrshme e jo të shëndetshme të prodhimit të energjisë siç është qymyri, është shfaqur nevoja e hulumtimit të burimeve tjera të prodhimit të energjisë të cilat, janë më të arsyeshme edhe në aspektin ambiental.

Kosova ka potencial për prodhimin e energjisë me anë të energjisë së ujit edhe pse jo në sasi të kënaqshme. Lumi Kaçandolli si degë e lumit Llap, për shkak të pozitës së shtrirjes dhe kapacitetit ujor, ka potencial për shfrytëzim në aspektin e prodhimit të energjisë elektrike. Kapaciteti hidroenergjetik nuk është aq i lartë, në bazë të prurjes llogaritet se HCV Majanci mund të arrij të prodhojë deri në 1.9 milionë kWh/vit. Rezultatet e dala nga ky punim mendoj se do të shërbejnë për hulumtime më të gjera në të ardhmen rreth ndërtimit të hidrocentraleve të vogla poashtu drejt studimit të fizibilitetit për ndërtimin e HCV Majanci.

Fjalët kyçe: Lum, akumulacion, rezervuar, vepër e marrjes, derivacion, hidrocentral, turbinë, analizë hidrologjike.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.